



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

FAKULTETI I FILOLOGJISË

PROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS							
Niveli i studimeve		Bachelor	Programi	Gjuhë dhe letërsi shqipe	Viti akademik	2020-21	
LËNDA		Letërsia romantike shqipe I					
Viti	2015	Statusi i lëndës	Obligative	Kodi		ECTS kredi	6
Semestri	Dimëror						
Javët mësimore		15 (pesëmbëdhjetë)		Orët mësimore 3+2		Ligjërata 3	Ushtime 2
Metodologjia e mësimit dhe përshkrimi i lëndës		Romantizmi fillon në vitet 30-40 të shekullit XIX dhe vazhdon deri në Shpalljen e Pavarësisë. Konceptet dhe fenomenet e formacionit stilistik të Romantizmit në letërsinë shqipe janë objekt studimi në lëndën Histori e letërsisë shqipe I – Romantizmi. Aspekti teoriko-kritik dhe analiza letrare përqendrohen tek autorët emblematikë dhe tek veprat e tyre.					
Mësimdhënës		Prof.ass.dr. Teuta Vinca Kafexholli		e-mail	teuta.kafexholli@kafexholli@gmail.com		
				Tel.	045- 405 444		

Qëllimi studimor i lëndës	Përfitimet e studentit
<p>Qëllimi i kursit Histori e letërsisë shqipe I – Romantizëm është që studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> të fitojë njohuri të duhura dhe sistematike për modelin kulturor të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. të ketë informacion për poetikën dhe strukturën e zhvillimit të formacionit stilistik të Romantizmit. të hartojë me kreativitet vështrimet dhe trajtesat e tij individuale që kanë të bëjnë me vepra të veçanta dhe fenomene të përgjithshme të romantizmit shqiptar. 	<p>Studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> të bëjnë krahasime në fushën e studimit midis romantizmit evropian dhe romantizmit shqiptar duke u nisur nga idetë, temat, kodet, ligjërimet, figurat, stilet etj. të komunikojë qartë me përbërësit e shkrimit romantik dhe me kritikën letrare për të. të sistemojnë konceptin dhe metodën e kërkimit të esencave në kuptimin letrar dhe në nivelin shkencor. të zotërojnë dijet më të avancuara për të dhënë vlerësime të pavarura në të shkruar dhe në të folur.

Metodologjia për realizimin e temave mësimore:			
Ligjëratat do të organizohen me modelin ndërveprues apo të kombinuar si: shpjegim – sqarim, ushtrime, analiza tekstore e shkencore, diskutime, punë në grupe, demonstrime dhe interpretime, shtruarje e shqyrtime idesh, hartime krijuese e vetëhulumtuese etj. Këto do të jenë pjesë kryesore për punën e vlerësimit dhe mënyrën apo metodologjinë e të ligjëruarit.			
Kushtet për realizimin e temës mësimore:			
Varësisht nga tema mund të organizohen dhe realizohen përmes komunikimit interaktiv, ligjërata në modelin klasik, përmes (kompjuterit dhe projektorit) etj.			
Mënyra e vlerësimit të studentit (në%)			
<p>Vlerësimi do të bëhet duke u mbështetur në vlerësimet me shkrim (dy teste gjatë vitit akademik), seminare, detyra të shtëpisë, angazhime në klasë dhe në testin përfundimtar.</p> <p>Pikët e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Testi i parë: 15 pikë • Testi i dytë: 15 pikë • Vijimi i rregullt dhe aktiviteti 10 pikë • Punim seminari 10 pikë • Vlerësimi i fundit (testi përfundimtar) 50 pikë. <p>Totali: 100 pikë</p>	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare	
			<p>Vlerat e pikëve:</p> <p>51-60 = 6 61-70 = 7 71-80 = 8 81-90 = 9 91-100 = 10</p> <p>Studentët me rezultat të përgjithshëm nën 50 pikë nuk mbërrijnë notën kaluese.</p>
<p>Obligimet e studentit: Të jenë pjesëmarrës aktiv, te punoje seminaret; prezantimet dhe hulumtimet e pavarura. Gjatë ligjëratave nuk u lejonet komunikimi me telefon apo modele të tjera të cilat pengojnë procesin e mësimin. Gjatë organizimit të testeve nuk lejonet kopjimi, komunikimi apo ardhja më vonesë, sepse do të pengojnë procesin e organizimit të testit.</p> <p>Testet apo provimet organizohen sipas plan-programit të paraparë dhe zgjatë një orë mësimore.</p>			
Ligjërata	Ushtrime		
Në ligjërata studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktiv, të kompletuar dhe të përgatitur me pajisje mësimore, dhe studimore për ta kuptuar dhe realizuar temën e dëgjuar apo plan-programin e lëndës.	/		
Ngarkesa e studentit për lëndën			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	1-15	45
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	1	1-15	15
Seminare, prezantime, teste, kolokfiume etj.	4	2-2	8
Detyra të shtëpisë	2	1-4	8

Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim	3	1-2	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, në provim final)	4	2	8
Totali			150

Java	Ligjërata	
	Tema	Orët
1.	Hyrje në lëndën e Historisë së letërsisë shqipe- Romantizmi I <ul style="list-style-type: none"> Dy fazat e rëndësishme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare Rilindja Kombëtare Shqiptare si një lëvizje e gjerë dhe e fuqishme çlirimtare Kushtet historike Lidhja e Prizrenit dhe zhvillimi i një veprimtarie të ngjeshur dhe shumë të frytshme 	3
2.	Veprimtaria kulturore në periudhën e Romantizmit Shqiptar <ul style="list-style-type: none"> Ideologjia dhe politika Veprimtaria artistike Letërsia romantike dhe kolonitë shqiptare Tri etapat kryesore të zhvillimit të letërsisë 	3
3.	Romantizmi shqiptar dhe struktura hapësinore <ul style="list-style-type: none"> Atdheu dhe kolonitë Kolonia e arbëreshëve të Italisë Kolonia e Stambollit Kolonia e Bukureshtit Kolonia e Kajros Kolonia e Sofjes 	3
4.	Romantizmi dhe poezia popullore <ul style="list-style-type: none"> Romantizmi dhe konteksti folklorist e historik Romantizmi dhe konteksti kulturor evropian Romantikët e huaj dhe folklori shqiptar Romantikët shqiptarë dhe letërsia popullore Motivet folklorike në strukturën romantike Ngjashmëria e modeleve figurataive Tejkalimi i ndjeshmërisë dhe modeleve folklorike 	3
5.	Përpjekjet për pastërtinë e gjuhës në periudhën e Romantizmit Shqiptar <ul style="list-style-type: none"> Barbarizmat dhe tjetërsimi gjuhësor Përkushtimi gjuhësor romantik Gjuha pa barbarizma Roli përgjithësues i gjuhës romantike 	3

6.	Hyrje në letërsinë arbëreshe <ul style="list-style-type: none"> • Rrethanat historike • Lëvizja kulturore • Lëvizja letrare • Përfaqësuesit kryesor të kësaj letërsie 	3
7.	Jeronim de Rada <ul style="list-style-type: none"> • Ndikimi i De Radës në letërsinë arbëreshe • Pikëpamjet politiko-shoqërore dhe eseistike • “Këngët e Milosaos” • “Skënderbeu i pafan” • “Një pasqyrë e jetës njerëzore” • Pikëpamjet estetike • Vepra e De Radës dhe kritika e huaj • Arti i De Radës 	3
8.	Provimi i parë intermediar	3
9.	Naum Veqilharxhi, mendimtar i shquar iluminist e veprimtar i Rilindjes <ul style="list-style-type: none"> • Mendimtar i shquar iluminist e veprimtar i Rilindjes • Rrethanat kombëtare dhe evropiane në veprimtarinë e N. Veqilharxhit • Pikëpamjet për kombin, gjuhën dhe arsimin • Arsimi kombëtar dhe alfabeti • Zhvillimi dhe përsosja gjuhësore 	3
10.	Anton Santori <ul style="list-style-type: none"> • Interesimi për letërsinë popullore • Poema “Këngëtorja shqipe” • Poemat politike • Poezia sitiriko-humoristike • Ndërtimi figurativ dhe ritmik i vargut • Proza: novela dhe romanet • Drama “Emira”; roli i hapësirës, personazhet në këtë dramë 	3
11.	Thimi Mitko <ul style="list-style-type: none"> • Proza historiko-letrare • Vjershat • Thesari shpirtëror popullor; “Bëleta Shqypëtare” • “Bëleta Shqypëtare” dhe rrethanat letrare evropiane • Llojet folklorike, koha dhe hapësira • Gjuha në teori dhe në praktikë 	3
13.	Jani Vreto <ul style="list-style-type: none"> • Ndërmjet letërsisë dhe shkencës • Proza e letrarizuar shkencoro-didaktike • Proza filozofike dhe etike • Proza polemike dhe proza oratorike • Gërshetimi romantiko-iluminist 	3

14.	Pashko Vasa <ul style="list-style-type: none"> • Proza historiko-publicistike, si prozë jetëshkrimore artistike • Motivet kryesore në poezitë e P.Vasës • Ndërtimi ritmik dhe tingullor i vargut • Romani “Bardha e Temalit”, kompozicioni • Ndërtimi kohor dhe hapësinor në romanin “Bardha e Temalit” • Ndjenja sentimentale • Gërshetimi romantiko-sentimental 	3
15.	Provimi i dytë intermediar	3

LITERATURA BAZË

Rexhep Qosja: *Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi I, II, III*, Rilindja, Prishtinë, 1984;1986.

Grup autorësh: *Historia e letërsisë shqiptare, Rilindja, Prishtinë, 1989.*

Robert Elsie: *Historia e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Pejë, 1997.*

LITERATURA SHITESË

Rexhep Qosja: *Porosia e madhe, Rilindja, Prishtinë, 1986.*

Eqrem Çabej: *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, MÇM, Tiranë, 1994.*

Sali Bashota: *Domethënia e ideve letrare, Rilindja, Prishtinë, 2001*

Sabri Hamiti: *Letërsia filobiblike dhe Letërsia romantike, Faik Konica, Prishtinë, 2002.*

Latif Berisha: *Vepra, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2002.*

Sali Bashota: *Studime letrare, Toena, Tiranë, 2008.*

Vërejtje për studentin:

Studentët duhet t’u përmbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së, rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimor Pritet që secili student të vijë me kohë dhe të marrë pjesë në çdo ligjeratë. Për shkak të natyrës dhe mënyrës së studimit në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është me rëndësi të veçantë. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t’i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave.